



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 1.3.2023

Nr: 79

Ora: 11:00

VENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË KOMITETIT SHQIPTAR TË HELSINKIT DHE ORGANIZATËS QËNDRESA QYTETARE, PËR VËZHGIMIN E ZGJEDHJEVE PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Sot, më datë 1.3.2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtova kërkesën e:

- KËRKUES:**
1. Komiteti Shqiptar i Helsinkit me seli në Tiranë,  
Rruga “Brigada e VIII”, me përfaqësuese znj. Erida Skëndaj dhe
  2. Organizata “Qëndresa Qytetare” me seli në Tiranë,  
Rruga “Hoxha Tahsim”, Pallati.” Vjero”, me përfaqësues z. Rigels Xhemollari

**OBJEKTI:** Kërkohet akreditimi si vëzhgues afatgjatë për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 6, 7, e 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe vendimi nr. 19, datë 27.01.2023 “Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja, dhe mediave”

Data: 1.3.2023 Nr: 79  
Ora: 11:00



“Për shqyrtimin e kërkesës së Komitetit Shqiptar të Helsinkit dhe organizatës Qëndresa Qytetare, për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 maj 2023”

## V Ë R E J:

Komiteti Shqiptar i Helsinkit i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën si dhe dokumentacionin përkatës për 28 (njëzet e tetë) vëzhgues afatgjatë si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Kërkesa e paraqitur respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5 të Kodit Zgjedhor. Komiteti Shqiptar i Helsinkit është subjekt i cili gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje, përcaktuar në nenin 6, pika 2 të Kodit Zgjedhor.

Organizata Qëndresa Qytetare i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën si dhe dokumentacionin përkatës për 30 (tridhjetë) vëzhgues afatgjatë si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Kërkesa e paraqitur respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5 të Kodit Zgjedhor. Organizata Qëndresa Qytetare është subjekt i cili gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje, përcaktuar në nenin 6, pika 2 të Kodit Zgjedhor.

## P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Si dhe në mbështetje të neneve 6, 7, e 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe vendimit nr. 19, datë 27.01.2023 “Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja, dhe mediave”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

## V E N D O S :

1. Akreditimin si vëzhgues afatgjatë për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023 të 28 (njëzet e tetë) vëzhguesve afatgjatë të Komitetit Shqiptar të Helsinkit, sipas listës së përcaktuar në lidhjen 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Akreditimin si vëzhgues afatgjatë për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023 të 30 (tridhjetë) vëzhguesve afatgjatë të organizatës Qëndresa Qytetare, sipas listës së përcaktuar në lidhjen 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**

